



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА  
PROGRAMI PËR MBËSHËTETJE PARLAMENTARE  
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

Dokument i shkurtë për politika publike nr.10/2022

-

**Pyetje parlamentare:  
Sa argumentuan deputetët dhe  
çfarë pyetën më shumë?  
(janar - dhjetor 2021)**

Autore: Nikola Mihajlovski

-

maj 2022

IMPLEMENTUAR NGA:





*Ky publikim është përpiluar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PSP implementohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN). Përmbajtja e botimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e SDC-së.*

## Rezyme ekzekutive

---

- Pyetjet e deputetëve janë instrument i rëndësishëm i Kuvendit për ushtrimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes mbi punën e Qeverisë. **Gjatë vitit 2021 në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut janë mbajtur 7 seanca për pyetje të deputetëve, në të cilat janë shtruar 104 pyetje nga 36 deputetë të ndryshëm në gjithsej 41 paraqitje për fjalë.**
- Nga pikëpamja gjinore, **gratë deputete morën pjesë me 35% të numrit të përgjithshëm të paraqitjeve për shkrimin e pyetje të deputetëve**, përkatësisht raporti i pyetjeve ishte dy me një në favor të deputetëve meshkuj.
- Katër nga pesë pyetje të deputetëve u shtruan nga deputetët e opozitës. **Nga tre deputetë, dy kanë shtruar numrin maksimal të pyetjeve nga foltorja, nga tre pyetje.** Çdo pyetje e dytë i adresohet kryeministrit të atëhershëm Zoran Zaev.
- Tre temat për të cilat u shtruan **më shumë pyetje të deputetëve kishin të bënin me fenomenin e korrupsionit, pandeminë KOVID-19, sundimin e ligjit dhe sistemin e jurisprudencës.**
- **75% e diskutimit ishte pa ose me argumentim të dobët.** Deputetët kishin një nivel më të lartë argumentimi në pyetjet e tyre sesa përfaqësuesit e qeverisë në përgjigjet e tyre. **Megjithatë, niveli i argumentimit të pyetjeve të deputetëve ulet edhe më shumë, për shkak të nivelit të ulët të argumentimit të pyetjeve plotësuese.** Përkatësisht, përkundër faktit se deputetët përdorin në mënyrë të konsiderueshme argumentet në pyetjet e tyre, kur është fjala për prononcimin pas përgjigjes, përkatësisht pyetjes plotësuese, vërehet nivel më i ulët i argumentimit, gjë që në përgjithësi e zvogëlon argumentimin e prononcimit të plotë të deputetëve. **Deputetët e opozitës kishin një nivel më të lartë argumentimi sesa deputetët e shumicës parlamentare.**
- **Çdo fjalim i dytë ishte pa argument drejtuar bashkëbiseduesit**, ndërsa në një nga dhjetë fjalime u evidentua adresim përkatës i argumenteve. **Diskutimi në përgjithësi u zhvillua pa iu referuar folësit të mëparshëm (66%).**

# 1. Introduction

---

**Një nga mënyrat se si Kuvendi mund të mbikëqyrë punën e pushtetit ekzekutiv është përmes pyetjeve të deputetëve.** Kuvendi ka kompetencë të përcaktuar me Kushtetutë për kontroll dhe mbikëqyrje politike mbi Qeverinë dhe mbi bartësit e tjerë të funksioneve publike që i përgjigjen Kuvendit (neni 68, alineja 17 e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut). **Kuvendi e ushtron kontrollin mbi punën e Qeverisë në tri mënyra: përmes të drejtës për miratimin e buxhetit dhe përmes instrumenteve për ushtrimin e kontrollit: pyetjeve të deputetëve dhe interpelancës. Mënyra e tretë është inicimi i procedurës për votimin e (mos)besim ndaj Qeverisë.<sup>1</sup>**

Në parlamentet e vendeve evropiane, intensiteti dhe afatet e parapara për mbajtjen e seancave për pyetjet të deputetëve, si dhe mënyra, kohëzgjatja dhe radha sipas së cilës do të shtrohen pyetjet rregullohet në mënyra të ndryshme. **Në Kuvendin tonë seancat për pyetjet e deputetëve mbahen zakonisht çdo të enjte të fundit të muajit. Deputetët e opozitës kanë përparësi t'i shtrojnë pyetje kryeministrit dhe funksionarëve të tjerë publik.** Rendi për shtrimin e pyetjeve të deputetëve caktohet nga Kryetari i Kuvendit në marrëveshje me koordinatorët e grupeve parlamentare, në mënyrë që të sigurohet raport dy me një në favor të deputetëve të grupeve parlamentare të opozitës dhe deputetëve të opozitës të cilët nuk janë të organizuar në grup parlamentar. **Në seancë,**

**deputeti/ja mund të shtrojë më së shumti tre pyetje. Parashtrimi i pyetjeve të deputetëve nuk mund të zgjasë më shumë se dhjetë minuta ndërsa deputeti/ja ka të drejtë të deklarohet nëse është i kënaqur me përgjigjen, përkatësisht të bëjë pyetje shtesë, por jo më gjatë se tre minuta.**

Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, pyetjet e deputetëve janë vendosur si të detyrueshme, ndërsa sipas Rregullores së Kuvendit, në seancë detyrimisht janë të pranishëm kryetari dhe anëtarët e Qeverisë dhe bartës të tjerë të funksioneve publike për të cilët është paralajmëruar se do t'u shtrohet pyetje.

Qëllimi i kësaj analize është që të jepet një pasqyrë për seancat e parapara për pyetje të deputetëve gjatë vitit 2021, ti paraqesë dhe elaboroj sipas fushave pyetjet që janë bërë më shpesh nga foltorja parlamentare. Njëkohësisht është paraqitur qëndrimi dhe intensiteti i diskutimit, përkatësisht niveli i argumentimit në pyetjet e deputetëve, si dhe në përgjigjet e anëtarëve të jashtëm.

---

<sup>1</sup> Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Instituti Parlamentar. Qasur në: <https://goo.gl/V9nSDN> (vizituar së fundi: 9 janar 2022)

## 2. Konteksti politik

**Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit 2021 ka mbajtur 7 seanca të parapara për pyetje të deputetëve.** Seanca e fundit për pyetje të deputetëve për përfaqësuesit e Qeverisë së udhëhequr nga Zoran Zaev është mbajtur më 24 qershor.

**Arsyet pse u shtynë seancat e pyetjeve të deputetëve ishin: pushimi kolektiv vjetor i deputetëve në gusht; zgjedhjet e parakohshme lokale në tetor dhe shpallja e zisë treditore pas aksidentit të autobusit në Bullgari.<sup>2</sup>**

Më 23 dhjetor, në seancën e 55-të për pyetje të deputetëve, u konfirmua dorëheqja e kryeministrit Zoran Zaev.<sup>3</sup> **Pas dorëheqjes, kryetari i Kuvendit Talat Xhaferi vlerësoi se është e papërshtatshme që të mbahen pyetjet e deputetëve sepse Qeveria po jep dorëheqje dhe kjo ishte një praktikë e vendosur nga e kaluara.** Opozita e kundërshtoi vendimin, duke iu referuar nenit 93, paragrafi 5 të Kushtetutës, ku thuhet se Qeverisë së cilës i është votuar mosbesim, e cila ka dhënë dorëheqje ose mandati i ka pushuar për shkak të shpërndarjes së Kuvendit, mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e Qeverisë së re. Pas dështimit të kërkesave të saj, opozita pati një përpjekje të pasuksesshme për të thirrur seancë të re parlamentare të enjten e fundit të vitit, më 30 dhjetor.

**Për krahasim, në vitin 2020 pyetjet e para të deputetëve u mbajtën në dhjetor, të cilat në fakt ishin të vetmet pyetje të deputetëve për atë vit kalendarik.** Për shkak të pandemisë KOVID-19, si dhe aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, Kuvendi nuk ka mbajtur seanca për pjesën më të madhe të vitit 2020 dhe funksioni i tij bazë praktikisht ka qenë i kufizuar.

**Në vitin 2019 janë mbajtur tetë seanca për pyetje të deputetëve, ndërsa në vitin 2018 gjithsej dhjetë. Nga dhjetë seancat për pyetje të deputetëve, opozita në vitin 2018 ishte e pranishme në shtatë.<sup>4</sup>**

Vitin e kaluar (2021) opozita ishte e pranishme në të shtatë seancat për pyetjet e deputetëve. **Në seancën e mbajtur në mars 2021, deputetët e shumicës, me marrëveshje paraprake me deputetët e opozitës, u tërhoqën nga mundësia për të shtruar pyetje të deputetëve, për t'i lënë më shumë kohë deputetëve të opozitës të shtrojnë pyetje.** Vendimi është marrë pasi po atë ditë është mbajtur një seancë tjetër plenare, në të cilën është miratuar pakoja e pestë e masave për ndihmë ekonomike për qytetarët për shkak të krizës së shkaktuar nga pandemia KOVID-19. Masat u mbështetën edhe nga deputetët e opozitës.

<sup>2</sup> Prolongimi i seancës për pyetje të deputetëve. Qasur në: <<https://www.slobodnaevropa.mk/a/31576973.html>> (Vizituar së fundi: 3 dhjetor 2021)

<sup>3</sup> Njoftim i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qasur në: <<https://vlada.mk/node/27297>> (vizituar për herë të fundit: 26 dhjetor 2021)

<sup>4</sup> Pyetje të deputetëve: Masë për mbikëqyrje mbi pushtetin ekzekutiv apo platformë për lavdërimet? Qasur në: <<https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2019/04/Пратенички-прашања-финална-верзија.pdf>> (Vizita e fundit: 26 janar 2022)

### 3. Gjetjet nga analiza

Duke përdorur Indeksën e Cilësisë së Debatit<sup>5</sup> si instrument, *Instituti për Demokraci* monitoroi të shtatë seancat të dedikuara për shtrimin e pyetjeve të deputetëve në vitin 2021. **Në shtatë seancat janë shtruar gjithsej 104 pyetje nga 36 deputetë të ndryshëm.** Prej tyre 27 deputetë janë të opozitës ndërsa 9 deputetët të tjerë që kanë shfrytëzuar të drejtën të shtojnë pyetje të deputetit, janë nga shumica parlamentare.

**80% e totalit të pyetjeve janë bërë nga deputetët e opozitës, ndërsa pjesa tjetër prej 20% ose më**

**saktë 21 pyetje të deputetëve janë shtruar nga deputetët e shumicës (Grafiku 1).**

Sa i përket përfaqësimit gjinor, dy të tretat e numrit të përgjithshëm të pyetjeve të deputetëve janë bërë nga deputetë meshkuj. Pjesa e tjetër prej 35% ishin pyetje nga gratë deputete, gjë që tregon se raporti i numrit të pyetjeve të bëra, si dhe raporti i numrit të përgjithshëm të pyetjeve ishte dy me një në favor të deputetëve meshkuj (Grafiku 1).

**Grafiku 1.** Pyetje të deputetëve të shtruara sipas përkatësisë politike dhe gjinisë (%)




**Dy të tretat, përkatësisht 66% e deputetëve në fjalën e tyre kanë shtruar nga tri pyetje të deputetëve.**

Nga dy pyetjeve të deputetëve, kanë shtruar 22% e deputetëve që kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre për të shtruar pyetje ndërsa vetëm një pyetje adresuar përfaqësuesve të qeverisë kanë shtruar 12% të

deputetëve gjatë fjalimeve të tyre. **Deputetët e opozitës ishin më të prirë të përdorin maksimumin e paraparë për pyetje të shtruara me gojë në një seancë, gjegjësisht shtatë nga dhjetë deputetë të opozitës kanë shtruar tri pyetje të deputetëve nga foltoerja (Grafiku 2).**

**Grafiku 2.** Numri i pyetjeve të deputetëve të shtruara (%)



<sup>5</sup> Indeks për cilësinë e debatit është një instrument i zhvilluar nga Instituti për Demokraci, i cili mundëson vlerësimin e cilësisë së debatit përmes kodimit të çdo fjalimi individual sipas disa karakteristikave kryesore: shkalla e argumentimit, shkalla e respektit për folësit e tjerë dhe argumentet e tyre, hapja për pranimin e argumenteve të të tjerëve dhe ndryshimi i qëndrimeve individuale për shkak të argumenteve më të mira dhe debatit pa ndërhyrje.

### 3.1 Çfarë kanë pyetur më shumë deputetët nga foltorja dhe kujt ja janë drejtuan pyetjet?

Më aktivë në parashtrimin e pyetjeve të deputetëve ishin deputetët Gordana Siljanovska Davkova dhe Bojan Stojanoski, të cilët arritën të parashtronë tri pyetje në tri seanca të ndryshme, përkatësisht dy deputetët kanë shtruar gjithsej nëntë pyetje të deputetëve. Deputeti Petar Risteski ka shfrytëzuar të drejtën për të bërë pyetje në dy seanca të ndryshme, duke parashtruar tri pyetje në një dhe një pyetje të deputetit në seancën e dytë (Tabela 1).

Pesëdhjetë e tre pyetje, gjegjësisht më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të pyetjeve të deputetëve i janë adresuar kryeministrit të atëhershëm Zoran Zaev. Milla Carovska si ministre e Arsimit iu përgjigj 9 pyetjeve të deputetëve, Venko Filipçe 8 pyetjeve dhe Oliver Spasovski 7 pyetjeve të deputetëve. Me fjalë të tjera, 75% e pyetjeve të shtruara iu drejtuan katër përfaqësuesve qeveritarë nga Tabela 1.

Tabela 1.

Deputetë	Numri i pyetjeve të deputetëve të shtruara
Gordana Siljanovska-Davkova	9
Bojan Stojanoski	9
Petar Risteski	4
Përfaqësues qeveritar	Numri i pyetjeve të deputetëve të përgjigjura gojarisht
Zoran Zaev	53
Mila Carovska	9
Venko Filipçe	8
Oliver Spasovski	7

Nga gjithsej 104 pyetje të parashtruara, shumica e pyetjeve (17) kanë trajtuar fenomenin e korrupsionit, dhe - të gjitha janë shtruar nga deputetët e opozitës. Për pandeminë vaksinat, masat ekonomike dhe shëndetësore për përballimin e KOVID-19 janë shtruar 15 pyetje të deputetëve (9 nga opozita, 6 nga pushteti; Grafiku 3).

Jo më pak vëmendje iu kushtua drejtësisë dhe


sistemit të jurisprudencës. Për çështje individuale gjyqësore, skandale, arratisje dhe reforma në gjyqësor, deputetët e shumicës kanë shtruar pesë, ndërsa deputetët e opozitës gjithsej dhjetë pyetje të deputetëve. Janë shtruar gjithsej dhjetë pyetje për reformat në arsim, tekstet elektronike dhe mënyrën e mësimdhënies gjatë pandemisë – të gjitha nga opozita (Grafiku 3).



Nëntë pyetje mbuluan mjedisin jetësor, duke përfshirë problemet me ndotjen, mënyrën e depozitimit të mbetjeve, statusin e zonave të mbrojtura dhe ngjashëm. Janë shtruar gjashtë pyetje për masat në bujqësi, grumbullimin e duhanit dhe të rrushit. **Për negociatat me Bashkimin Evropian,**

**metodologjinë e zgjerimit, veton për fillimin e negociatave janë shtruar pesë pyetje – të gjitha nga opozita.** Pesë pyetje kishin të bënin me planifikimin ekonomik, investimet, inovacionin dhe katër pyetje lidhur me mbajtjen e regjistrimit të popullsisë (Grafiku 3).

**Grafiku 3.** Numri i përgjithshëm i pyetjeve të deputetëve të grupuara sipas temave të përmbytjes dhe fushave



### 3.2 Shkalla e argumentimit


Sipas shkallës së argumentimit në seancat për pyetje të deputetëve, **diskutimi zakonisht ka qenë pa argumentim (51%)**. Në 21% të diskutimit është vërejtur të paktën një argument, në 4% u gjetën dy argumente, **ndërsa pjesa tjetër e 24% të diskutimeve ishin me arsyetim të dobët**. Fjalimet me më shumë se dy argumente nuk janë vërejtur në seancat për pyetje parlamentare (Grafiku 4).

Nëse analizohet argumentimi i fjalimeve të bashkëbiseduesve të jashtëm në raport me ato të deputetëve, vërehet se bashkëbiseduesit e

jashtëm kanë nivel më të lartë argumentimi. **Kështu, përfaqësuesit e qeverisë kanë përdorur një argument në 32% të përgjigjeve të tyre ndaj deputetëve dhe dy argumente në 5%. Sa i përket deputetëve, në 13% të pyetjeve të tyre është vërejtur një argument, ndërsa në 4% dy argumente (Grafiku 4).**

Sa i përket përkatësisë politike të deputetëve, **vërehet se deputetët e shumicës parlamentare kishin argumentim më të dobët se kolegët e tyre nga opozita (80% pa argument, kundrejt 52% të opozitës; Grafiku 4).**


**Grafiku 4.** Shkalla e argumentimit sipas përkatësisë politike (%)



Deputetët në 15% të pyetjeve të tyre kanë përdorur dy argumente, në krahasim me dy argumente të përdorura në 5% të përgjigjeve të anëtarëve të jashtëm. **Lloji më pak i argumentuar i fjalimit (74%) është prononcimi pas përgjigjes në pyetjen e deputetit dhe mundësia që deputetët të bëjnë**

**pyetje shtesë brenda tre minutave.** Megjithatë, përqindja e lartë e mosargumentimit të deputetëve në instrumentin e pyetjeve plotësuese, lejon që argumentimi i anëtarëve të jashtëm, i parë në përgjithësi gjatë diskutimit, të jetë më i theksuar (Grafiku 5).

**Grafiku 5.** Shkalla e argumentimit sipas llojit të fjalimit (%)



### 3.3 Kush tregoi më shumë përgjegjësi nga foltorja parlamentare?


Përgjegjësia është një instrument që tregon se sa folësit folën rreth temës së rendit të ditës ose rreth fjalimit të folësit të mëparshëm nëse ai ka adresuar argument ose pyetje. **Në 51% të diskutimeve në seancat e pyetjeve të deputetëve nuk është vërejtur asnjë argument referuar folësit paraprak.** Argumente të adresuara pjesërisht, të cilat injorohen ose shtrembërohen në 24%, ndërsa argumentet e injoruara plotësisht janë të pranishme në 9% të diskutimit. **Argumente të adresuara në mënyrë përkatëse janë në 11% të fjalimeve** (Grafiku 6).

Anëtarët e jashtëm janë më të përgjegjshëm në këtë aspekt, sepse në 20% të diskutimit kanë

**adresuar në mënyrë përkatëse argumentet**, në krahasim me 6% të deputetëve të opozitës dhe 1% të deputetëve të shumicës. Gjithashtu, anëtarët e jashtëm në një numër më të vogël fjalimesh i kanë injoruar plotësisht argumentet (6% e fjalimeve të tyre, kundrejt 15% të deputetëve të shumicës dhe 11% të opozitës; Grafiku 6).

Shtrembërimi i plotë i pikës së argumenteve të adresuara paraprakisht ndodhi në 8% të përgjigjeve të anëtarëve të jashtëm. **Për sa i përket deputetëve, në 5% të fjalimeve të opozitës ka pasur shtrembërim të argumentit, ndërsa tek deputetët e shumicës nuk është vërejtur një fjalim i tillë** (Grafiku 6).

**Grafiku 6.** Përgjegjësia sipas llojit të anëtarit dhe përkatësisë politike (%)



### 3.4 Fuqia e argumentit më të mirë

Nëpërmjet këtij instrumenti analizohet nëse qëndrimi i folësit ka ndryshuar për shkak të argumenteve më të mira të pjesëmarrësve të tjerë në diskutim. Në të njëjtën kohë, vërehet nëse pjesëmarrësit në diskutim i kanë pranuar argumentet e bashkëbiseduesve, apo i kanë refuzuar ato. **Në dy nga tre fjalimet pjesëmarrësit nuk iu referuan fjalimeve të mëparshme, gjegjësisht nuk iu referuan argumenteve, ndërsa në 23% të fjalimeve nuk kishte ndryshim të qëndrimit dhe nuk është pranuar vlera e argumentit të paraqitur më parë.**


Fuqia e argumentit më të mirë nëse analizohet sipas përkatësisë politike të deputetëve, **mund të vërehet se deputetët e shumicës e kanë pranuar**

**në mënyrë më të shprehur vlerën e argumentit të përfaqësuesve të Qeverisë** (16%, krahasuar me 3% te deputetët e opozitës; Grafiku 7).

Për rrjedhojë, **deputetët e opozitës në 21% nuk e kanë pranuar vlerën e argumentit të bashkëbiseduesit të cilit i kanë bërë pyetje.** Te deputetët e shumicës kjo ka ndodhur në 4% të rasteve. Anëtarët e jashtëm nuk e kanë pranuar vlerën e argumenteve në pyetjet të cilat u janë shtruar atyre në 31% të rasteve/ fjalimeve.

**Ndryshim në qëndrimin si pasojë e pranimit të argumentit të shprehur nuk është evidentuar në seancat për pyetje të deputetëve në vitin 2021** (Grafiku 7).

**Grafiku 7.** Forca e argumentit më të mirë sipas përkatësisë politike dhe llojit të anëtarit (%)




### 3.5. Qëndrimi i deputetëve dhe anëtarëve të jashtëm ndaj argumenteve dhe personalitetit të bashkëbiseduesit

Deputetët në përgjithësi nuk iu referuan argumenteve të anëtarëve të jashtëm. (80% te shumica, kundrejt 77% te deputetët e opozitës). Zakonisht, as anëtarët e jashtëm nuk kanë pasur referencë ndaj pyetjeve argumentuese të shtruar nga deputetët (68%, grafiku 7).

Vlerësimi i përgjigjeve të anëtarëve të jashtëm ka

qenë më i theksuar te deputetët e shumicës të cilët në 12% të fjalimeve kanë treguar respekt për argumentet e tyre, po ashtu me 4% respekt të pjesshëm. Në të kundërt, deputetët e opozitës në 15% të fjalimeve treguan mungesë respekti ndaj argumenteve të përfaqësuesve të qeverisë, ndërsa në 4% mosrespektim të pjesshëm (Grafiku 7).


**Grafiku 8.** Qëndrimi i deputetëve dhe anëtarëve të jashtëm ndaj argumenteve të bashkëbiseduesit (%)



Qëndrimi i pjesëmarrësve ndaj argumenteve të bashkëbiseduesit reflektohet edhe në qëndrimin e tyre ndaj personalitetit të bashkëbiseduesit. Përkatësisht, në fjalimet nga foltorja e Kuvendit përgjithësisht nuk është komentuar personaliteti i bashkëbiseduesit. **Mirëpo, në rastet kur deputetët**

**kanë komentuar personalitetin e anëtarëve të jashtëm, deputetët e shumicës kanë treguar respekt për përfaqësuesit e qeverisë (8%), ndërsa deputetët e opozitës kanë treguar mungesë respekti (10%), gjegjësisht mosrespektim të pjesshëm (9%, Grafiku 8).**

**Grafiku 9.** Qëndrimi i deputetëve dhe anëtarëve të jashtëm ndaj personalitetit të bashkëbiseduesit (%)



## 4. Konkluzione dhe rekomandime

Ushtrimi i funksionit mbikëqyrës të Kuvendit nënkupton kontroll mbi punën e Qeverisë në tërësi, ndërsa mjeti i pyetjeve të deputetëve, efikasiteti i të cilave mund dhe duhet të jetë në nivel më të lartë është një nga mënyrat për të arritur këtë qëllim.

Që përfitimet e këtij mjeti të jenë më të mëdha, duhet konsistencë më e madhe në mbajtjen e seancave për pyetje të deputetëve, që mund të arrihet me ndryshimin e nenit 39, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit.

Njëkohësisht, është me rëndësi që më shumë deputetë të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për të shtruar pyetje. **Në vitin 2021, të drejtën për të shtruar pyetje të deputetëve e kanë shfrytëzuar 30% e deputetëve, që nuk përbën një të tretën e përbërjes së përgjithshme të deputetëve.**

Nga ana tjetër, gjysma e pyetjeve i janë drejtuar kryeministrit të atëhershëm, përkatësisht tre nga katër pyetjet i janë drejtuar kryeministrit apo ministrave për Punë të Brendshme, Arsim dhe Shëndetësi. **Kjo tendencë dhe selektivitet privoi mundësinë që publiku i gjerë të marrë më shumë informacion për punën e shumë bartësve të tjerë të funksioneve dhe institucioneve publike.**

Është pozitive që deputetët e opozitës dhe të pushtetit kanë qenë të pranishëm në të gjitha seancat për pyetje të deputetëve. **Megjithatë, në tre pyetje të cilat iu shtruan bartësve të funksioneve publiku u përgjigj kryeministri, për faktin se në seancë nuk ishin të pranishëm anëtarët e jashtëm të cilëve iu është shtruar pyetja.** Dispozitat e Rregullores sugjerojnë në detyrimin për pjesëmarrje të detyrueshme në seancat në të cilat është paralajmëruar se do të shtrohet pyetje.

Po të marrim parasysh fjalimet të cilat më tepër kishin tendencë për të lavdëruar bashkë-partiakët e qeverisë, apo diametralisht e kundërta - fjalimet me ofendime drejtuar tyre, është e dukshme nevoja për një efikasitet më të madh të mjetit pyetje të deputetëve. **Pyetjet plotësuese si pjesa më pak argumentuese e diskutimit tregojnë se ka vend dhe duhet gjetur një mënyrë për konstruktivitet më të madh në diskutim dhe ballafaqim me argumente.**

